

URDHËR
Nr. 73, datë 5.7.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave, Zëvendësministrit të Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi, për trajtimin e praktikës nr. 3361 Prot., datë 13.6.2017, të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me objekt detajimin e investimeve për vitin 2018 - 2019, për programin “Transporti Rrugor”, sipas parashikimeve të legjislacionit buxhetor në fuqi.
 2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave, për çështjen e përcaktuar në pikën 1 (një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi, deri në shfuqizimin e tij.
 3. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Zëvendësministri i Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Helga Vukaj